Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura XI
Komisioni për Buxhet
Mbledhja nr.06
Prishtinë, më 21.10.2026, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, Salla C-203

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Enver Haliti, Mërgim Lushtaku, Arbërie Nagavci, Ilir Kërçeli, Valon Hoti, Elvira Ibrahimi-Hoti, Ariana Musliu-Shoshi, Avdullah Hoti, Teuta Haxhiu dhe Emilija Rexhepi anëtarë të Komisionit.

Munguan:

Pjesëmarrës të tjerë: Hekuran Murati, ministër i Financave, Salvador Elmazi, drejtor i Buxhetit, MF; Shukrije Stublla, këshilltare, Kuvend; Benjamin Kurti, gazetar; Errita Bejtullahu, asistente, GP LVV; Jeton Bajraktari, Kuvend; Valdet Hadri, Kuvend; Violeta Haxholli, KDI; Edon Uka, GP PDK; Nexhmije Ahmeti, Kuvend; Berzat Berzati, asistent, Kuvend.

Stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Saliuki, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi Enver Haliti, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.10/L-001mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2026;**
4. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari konstatoi se me shumicë votash, komisioni e miratoni rendin e ditës.

2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.10/L-001mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026**

Kryetari theksoi se Komisioni për Buxhet, në bazë të nenit, 80 dhe 81 të Rregullores së Kuvendit, shqyrton dhe amendamenton Projektligjin nr.11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.10/L-001, mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime.

Brenda afatit ligjor, në komision kemi pranuar gjithsej 5 amendamente (dhe një amendament, të cilin e propozojmë ne si komision për harmonizimin e tabelave të buxhetit).

Për këtë pikë kemi të ftuar edhe ministrin e Financave, z. Hekuran Murati.

Mergim Lushtaku, lidhur me nenin 5 të projektligjit, ngriti çështjen e formulimit të fjalisë "Qeveria mund të miratojë pagesën e kompensimit". Ai theksoi se fjala "mund" duhet të zëvendësohet, pasi bëhet fjalë për një dispozitë ligjore dhe, duke pasur parasysh vendimin e Gjykatës Kushtetuese, çështja nuk duhet të mbetet në diskrecionin e Qeverisë.

Hekuran Murati, tha se kjo është më shumë çështje financiare sesa juridike. Sipas tij, formulimi i propozuar krijon bazën ligjore për realizimin e kompensimit retroaktiv.

Avdullah Hoti, theksoi se në rastin konkret formulimi duhet të jetë "Qeveria duhet të ndajë mjete për pagesën e kompensimit". Ai shtoi se, meqenëse ekziston vendimi i Gjykatës Kushtetuese, çështja nuk është më në diskrecionin e Qeverisë, por përbën obligim për ekzekutivin.

Kryetari, lidhur me nenin 6 të Projektligjit, njoftoi se Komisioni për Mirëqenie Sociale, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe për Persona të Pagjetur ka propozuar një amendament që ka të bëjë me nenin 32 të Ligjit Bazik, përkatësisht me paragrafin 2 të nenit 32/A, me këtë përmbajtje:

"Të shtohen edhe një milion euro (1,000,000 €) për pajisjet, protezat dhe mjetet tjera mjekësore për invalidët e luftës".

Hekuran Murati, lidhur me këtë çështje, tha se tashmë ekziston një rregullim institucional, pasi në mars të vitit 2024, është miratuar udhëzimi administrativ, i cili e mbulon këtë kosto përmes Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Kryetari theksoi se edhe ai kishte marrë informacion nga Ministria e Shëndetësisë, se gjatë vitit 2024, ministri i Shëndetësisë kishte nxjerrë dy vendime që kanë të bëjnë me personat me statusin e invalidit të luftës së UÇK-së dhe personat me statusin e invalidit civil të luftës. Përmes këtyre vendimeve është përcaktuar mundësia e mbulimit financiar të shpenzimeve për ndërrimin, mirëmbajtjen dhe vendosjen e protezave, në përputhje me kërkesat individuale të aplikantëve.

Sipas raporteve të deritanishme, nga zbatimi i këtyre vendimeve kanë përfituar 103 persona, me një vlerë të përgjithshme prej 1,488,631 eurosh. Ai theksoi se të gjitha kërkesat e parashtruara për mbulimin e këtyre shpenzimeve janë kompensuar.

Mërgim Lushtaku theksoi se amendamenti është i qëlluar, duke shtuar se çdo ditë ka kërkesa nga invalidët e luftës për sigurimin e protezave. Ai kundërshtoi pohimin se të gjitha shpenzimet përkatëse janë të mbuluara.

Teuta Haxhiu vlerësoi se amendamenti është i qëlluar, duke theksuar se invalidët e luftës kanë kaluar nëpër një realitet të dhimbshëm. Ajo tha se shumë prej tyre janë detyruar të mbështeten te miqtë dhe shokët në diasporë, të cilët u kanë ndihmuar vazhdimisht për ndërrimin e protezave dhe kujdesin shëndetësor. Sipas saj, kjo kategori është lënë anash nga institucionet e Kosovës. Ajo shprehu dëshirën që asnjë person që ka nevojë për ndërrimin e protezave, të mos mbetet pa ndihmën e nevojshme dhe të mos përballet me vështirësi në sigurimin e tyre.

Avdullah Hoti përkrahu amendamentin dhe e mirëpriti deklarimin se kjo çështje është adresuar përmes vendimit të vitit 2024. Ai theksoi se vetë diskutimi për këtë çështje dëshmon dështimin e shoqërisë dhe të institucioneve për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme dhe për ta adresuar atë njëherë e përgjithmonë. Sipas tij, qeveritë e njëpasnjëshme kanë dështuar në institucionalizimin e kujdesit për këtë kategori.

Ai rikujtoi se në vitin 2020 ishte arritur një marrëveshje me veteranët e luftës, me qëllim që kjo çështje të institucionalizohej dhe të përfshihej në buxhetin e rregullt të Klinikës së Ortopedisë në QKUK. Në përfundim, shprehu bindjen se kjo çështje duhet të adresohet në kuadër të buxhetit për vitin 2027, në rast se Qeveria nuk e përfshin atë në propozimin e saj.

Ariana Musliu-Shoshi mbështeti amendamentin, duke theksuar se mbështetja për këtë kategori është përgjegjësi institucionale dhe se nevojat e tyre duhet të përfshihen në buxhetin e rregullt, përmes një kodi të veçantë buxhetor, e jo të adresohen përmes amendamenteve.

Kryetari konstatoi se, pas përfundimit të diskutimeve, amendamenti nuk mori mbështetjen e Komisionit, me 5 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime.

Kryetari, njoftoi se do të shqyrtohen amendamentet e propozuara nga deputetët, të paraqitura në pjesën tabelore, gjithsej katër amendamente: një nga deputetja Teuta Haxhiu dhe tri nga deputetja Ariana Musliu-Shoshi.

Teuta Haxhiu paraqiti amendamentin për ndërtimin e një obelisku përkujtimor, kushtuar fëmijëve shqiptarë të vrarë gjatë periudhës 1989–1999 në Kosovë, me vlerë prej 589,700 eurosh. Ajo theksoi se ky projekt ka rëndësi për ruajtjen e kujtesës historike dhe nderimin e 1,400 fëmijëve të vrarë

gjatë kësaj periudhe. Për financimin e projektit, propozoi që mjetet të sigurohen nga kategoria me kod 205000 në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nga kategoria "Mallra dhe Shërbime" ose nga cilido program i Ministrisë së Financave, me kod 201, sipas vlerësimit të Qeverisë.

Miratimi i këtij amendamenti do të përbënte një hap konkret drejt institucionalizimit të kujtesës historike dhe nderimit të përhershëm të fëmijëve të vrarë, duke përcjellë te brezat e ardhshëm mesazhin se jeta e çdo fëmije është e shenjtë dhe se sakrifica e tyre nuk do të harrohet.

Kryetari konstatoi se, pas përfundimit të diskutimeve, amendamenti nuk mori mbështetjen e Komisionit, me 4 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime.

Ariana Musliu-Shoshi prezantoi amendamentin për ndërtimin e Qendrës së Kujdesit Paliativ, në vlerë prej 4,000,000 eurosh. Ajo theksoi mungesën e kapaciteteve të specializuara për kujdesin paliativ në Kosovë dhe barrën e madhe emocionale, fizike dhe financiare me të cilën përballen familjet që kujdesen për pacientët me sëmundje të rënda dhe të pashërueshme. Sipas saj, ndërtimi i kësaj qendre do të mundësonte ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe përkujdesjen dinjitoze për pacientët, duke lehtësuar njëkohësisht barrën e familjeve të tyre.

Kryetari konstatoi se, pas përfundimit të diskutimeve, amendamenti nuk mori mbështetjen e Komisionit, me 4 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime.

Ariana Musliu-Shoshi prezantoi amendamentin për ndërtimin e Qendrës për Fëmijët me Autizëm, Sindromën Down dhe Nevoja të Tjera të Veçanta, në vlerë prej 2,000,000 eurosh. Ajo theksoi se kapacitetet institucionale në Kosovë janë të pamjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të specializuara edukative, terapeutike dhe rehabilituese. Gjithashtu, vuri në pah vështirësitë me të cilat përballen familjet në sigurimin e këtyre shërbimeve dhe barrën e madhe të përkujdesjes që rëndon mbi prindërit. Sipas saj, ndërtimi i kësaj qendre do të mundësonte mbështetje profesionale për fëmijët dhe familjet e tyre, si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës dhe përfshirjen sociale të fëmijëve.

Kryetari konstatoi se, pas përfundimit të diskutimeve, amendamenti nuk mori mbështetjen e Komisionit, me 4 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime.

Ariana Musliu-Shoshi prezantoi amendamentin për përmirësimin e qasjes infrastrukturore në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara, në vlerë prej 800,000 eurosh. Ajo theksoi se pengesat infrastrukturore në shkollat e Kosovës kufizojnë qasjen e barabartë të këtyre fëmijëve në arsim. Sipas saj, investimi do të mundësonte ndërtimin e rampave, instalimin e ashensorëve dhe përshtatjen e hapësirave shkollore, me qëllim eliminimin e barrierave fizike dhe krijimin e një mjedisi arsimor të qasshëm dhe gjithëpërfshirës.

Kryetari konstatoi se, pas përfundimit të diskutimeve, amendamenti nuk mori mbështetjen e Komisionit, me 4 vota për, asnjë kundër dhe 6 abstenime.

Kryetari konstatoi se, pas përfundimit të diskutimeve, me 6 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Të miratohet Projektligji nr.11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.10/L-001, mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional si në vijim:

I. Amendamentet në pjesën tekstuale të projektligjit

Amendamenti 1 - Komisioni funksional

Neni 5 i projektligjit, në paragrafin 3, ndryshohen fjalët "mund të miratojë" në "miraton", pjesa tjetër e tekstit të paragrafit mbetet si në projektligj.

Amendamenti 2 - Komisioni për Mirëqenie Sociale, Punë, Familje, Vlerat e Luftës Çlirimtare, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Persona të Pagjetur - pa përkrahjen e Komisionit funksional

Në nenin 6 të projektligjit, që ka të bëjë me nenin 32 të Ligjit bazik, te paragrafi 2. Nenit 32/A, në fund të tekstit, shtohet teksti si në vijim:

"Të shtohen edhe një milion euro (1,000,000 €) për pajisjet, protezat dhe mjetet tjera mjekësore për invalidët e luftës".

II. Amendamentet në pjesën tabelore të projektligjit

Amendamenti 3 - deputetja Teuta Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit funksional

Ndërtimi i Obeliskut të fëmijëve të vrarë në luftën e fundit në Kosovë në vitet 1989-1999. Vlera e këtij projekti është 589.700.00 euro.

Të krijohet projekt i ri apo të rritet shuma buxhetore për 600 mijë euro në cilëndo kategori.

Mjetet buxhetore mund të merren apo barten nga kategoria me kod 205000, te Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Gjithashtu, mjetet mund të merren te kategoria "Mallra dhe Shërbime", apo në cilindo program të Ministrisë së Financave, me kod 201, ku Qeveria e vlerëson të mundshme.

Amendamenti 4 - deputetja Ariana Musliu- Shoshi, pa përkrahjen e Komisionit funksional

- **Ndërtimi i Qendrës së Kujdesit Paliativ – 4,000,000 euro.**

Në organizatën buxhetore "Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve", me kod 201, në nënprogramin "Kontigjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, propozohet ndarja buxhetore në kategorinë "Subvencione dhe Transfere" për shumën prej **4,000,000 eurosh**.

Shuma e njëjtë propozohet të ndahet në kategorinë "Investime Kapitale" për realizimin e projektit të ri.

Amendamenti 5 - deputetja Ariana Musliu- Shoshi, pa përkrahjen e Komisionit funksional

- **Ndërtimi i Qendrës për Fëmijët me Autizëm, Sindromën Down dhe Nevoja të Tjera të Veçanta – 2,000,000 euro**
-

Në organizatën buxhetore "Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve", me kod 201, në nënprogramin "Kontigjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, propozohet ndarja buxhetore në kategorinë "Subvencione dhe Transfere" për shumën prej **2,000,000 eurosh**.

Shuma e njëjtë propozohet të ndahet në kategorinë "Investime Kapitale" për realizimin e projektit të ri.

Amendamenti 6 - deputetja Ariana Musliu- Shoshi, pa përkrahjen e Komisionit funksional

- **Përmirësimi i qasjes infrastrukturore në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara – 800,000 euro**

Në organizatën buxhetore "Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve", me kod 201, në nënprogramin "Kontigjencat në Ministrinë e Financave", me kod 28900, propozohet ndarja buxhetore në kategorinë "Subvencione dhe Transfere" për shumën prej **800,000 eurosh**.

Shuma e njëjtë propozohet të ndahet në kategorinë "Investime Kapitale" për realizimin e projektit të ri.

Amendamenti 7 - Komisioni funksional

Harmonizimi i tabelave të buxhetit, bëhet në pajtim me amendamentet e miratuara në pjesën tabelore të Projektligjit nr.11/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, për vitet 2026-2028.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2026;

Kryetari, në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe praktikës së punës së komisioneve parlamentare, Komisioni për Buxhet harton planin dhe programin e punës për sesionin vjeshtor

2026. Plani përfshin objektivat, rregullat për funksionimin e brendshëm, fushëveprimin, aktivitetet dhe detyrat të paraqitura në forme tabelore, për arritjen e objektivave të përcaktuara.

Kryetari konstatoi se me 9 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plani i punës së Komisionit për sesionin vjeshtor për vitin 2026.

4. Të ndryshme

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se, gjatë raportimit të RTK-së, në vendimin e marrë kishte ndodhur një gabim, pasi gjysma e buxhetit të RTK-së, e planifikuar për pjesën e dytë të vitit, ishte ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, në kohën kur Kuvendi nuk kishte qenë funksional. Për këtë arsye, ai theksoi se vendimi paraprak duhet të anulohet dhe të nxirret një vendim i ri, në shumën prej 2,240,000 eurosh.

Kryetari konstatoi se, me 10 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni nxori këtë:

VENDIM

1. Miratohet Programi i Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën korrik - dhjetor 2026, në shumë prej 2,240,000 euro (dy milionë e dyqind e dyzet mijë euro);

2. Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit në Ministrinë e Financave, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, në buxhetin e Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr.1110-10121906-0187, për periudhën korrik - dhjetor 2026, në shumë prej 2,240,000 euro (dy milionë e dyqind e dyzet mijë euro);

3. Shfuqizohet vendimi nr. 11-V-03, i mbledhjes së komisionit, të mbajtur më datë: 14.10.2026.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Enver Haliti,

Kryetar i Komisionit